

**October 30, 1961**

**Telegram from the Foreign Affairs Minister of the Democratic Republic of Vietnam Ung Van Khiem to the Albanian Foreign Affairs Minister Behar Shtylla**

**Citation:**

"Telegram from the Foreign Affairs Minister of the Democratic Republic of Vietnam Ung Van Khiem to the Albanian Foreign Affairs Minister Behar Shtylla", October 30, 1961, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1961 D.217  
<https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/111462>

**Summary:**

This document is a telegram from the Foreign Affairs Minister of North Vietnam Ung Van Khiem to the Albanian Foreign Affairs Minister Behar Shtylla. Van Khiem describes to Shtylla the history of American-Vietnamese relations from the 1954 Geneva Convention until 1961. Van Khiem stresses that the situation in South Vietnam has worsened after President Kennedy took office. During May 1961, Vice President Lyndon B. Johnson came to Saigon and discussed with the President of the Republic of Vietnam Ngo Dinh Diem the prospect of enlarging American presence in South Vietnam. Since that time the South Vietnamese government, with American support, organized internment camps and a cordon sanitaire in the area of the South Vietnamese borders with Laos and Cambodia. Van Khiem sees these actions as menacing to peace in Indochina, and Southeast Asia more generally. The North Vietnamese government, abiding by the Geneva Convention on Indochina, proposed organizing a conference with the South Vietnamese authorities in order to discuss free elections throughout the country and the reunification of Vietnam. The government of the Democratic Republic of Vietnam denounced the American plans to enlarge the scope of aggressive actions in Vietnam and, especially, the plan to deploy the U.S. Army in South Vietnam.

**Original Language:**

Albanian

**Contents:**

Original Scan

V.  
Dosja

DEKLASIFIKUAR

2491

1200

21

1200

MINISTRIS P. JASHTËME

MPJ ARKIVI  
Viti:  
Dosja:  
Fleta:TEPËR URGJENT

Përkthim në Hanoi me 30 Tetor 1961

I dashur Shoku Ministër,

Në emër të Qeverisë së Republikës demokratike të Vietnamit kam nderin t'ju dërgoj përshëndetjet më të nderuara dhe të tërheq vëmendjen e Qeverisë së Republikës popullore të Shqipërisë mbi gjëndjen e rëndë që po krijon tani/acarimi i ndërhyrjes së Shteteve të Bashkuara. Komët e fundit Presidenti i Shteteve të Bashkuara Kenedi deklaroi zyrtarisht se qeveria e tij ka ndërmend të futë forca të armatosura amerikane në Vietnamin e Jugut, bën mbledhje pas mbledhjesh mbi problemin e Vietnamit të Jugut dhe dërgon me urgjencë gjeneralin Taylor në Saigon për këtë qëllim. Për të pregatitur opinionin publik në lidhje me hyrjen e trupave amerikane në Vietnamin e Jugut, aparati i propagandës amerikane është duke bërë një fushatë shpifëse/ në lidhje me t'ashtuquajturën penetrim të njësave ushtarake të Republikës demokratike të Vietnamit në Vietnamin e Jugut. Marëveshjet e Gjenevës të vitit 1954 që vëndosin paqën në Vietnam mbi bazën e njohjes së pavarsisë, sovranitetit, unitetit dhe intergjtetit të saj tokësor parashikonin ribashkimin e vendit me anë të zgjedhjeve të lira të përgjithëshme në gjithë territorin në korrik 1956. Me gjithë atë, mbas përfundimit të marëveshjeve të Gjenevës të vitit 1954, Qeveria e Shteteve të Bashkuara i mënjanoi autoritetet koloniale franceze duke ndërhyrë brutalisht në Vietnamin e Jugut. Në vonë, ajo nxiti autoritetet e Ngo Dinhx Diemit që të shkelin marëveshjet e Gjenevës, të kundërshtojnë konferencën konsultative, të kundërshtojnë zgjedhjet e lira dhe të sabotojnë paqën dhe ribashkimin e Vietnamit në rrugën e pragtitjeve aktive, me qëllim që të shpërthejnë një luftë të re në këtë zonë. Që nga viti 1954

Viti:  
Dosja:

DEKLASIFIKUAR 2.

Viti:  
Dosja: Fleta:

Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka futur në Vietnamin e Jugut në shumë se 3000 ushtarë amerikanë, me qindra mijë ton armatime dhe po ndërton urgjentisht baza ushtarake. Për realizimin e kësaj politike të forcimit ushtarak dhe përgatitjeve për luftë autoritetet e Vietnamit të Jugut, të vena pas qerres së Shteteve të Bashkuara, kanë ushtruar një terror t'egër kundër patriotëve dhe kanë shtypur të gjitha manifestimet e popullsisë për paqë dhe bashkimin kombëtar, liritë demokratike dhe përmirësimin e nivelit të jetës. Këto shtatë vjet të fundit, ato kanë masakruar 77.500 veta, kanë arrestuar 527.000 të tjerë nga të cilët 270.000 ndodhen akoma në burg. Kjo ndërhyrje e Shteteve të Bashkuara në punët e Vietnamit të Jugut është <sup>lehtë</sup> posaçërisht e rëndë që nga ardhja në fuqi e Presidentit Kenedi. Në maj 1961, N/Presidenti i Shteteve të Bashkuara Lindon Johnson erdhi në Saigon për të biseduar me Ngo Dinh Diemin në lidhje me planin e përhapjes së agresionit amerikan në Vietnamin e Jugut. Për vënien në jetë të ketyre qëllimeve të errta, u hartua një plan veprimi, i ashtuquajtur programi Stalei, me emrin e shefit të një misioni ushtarak të përbashkët amerikan të futur në Vietnamin e Jugut në qershor 1961 për studimin e situatës. Në kuadrin e këtij programi, qeveria e Shteteve të Bashkuara është duke ndihmuar autoritetet e Ngo Dinh Diemit që t'i shpërforcojë ushtarake në 500.000 veta dhe të forcojnë njëkohësisht repartet tjera. Shtetet e Bashkuara kanë futur dhe po vazhdojnë të futin në Vietnamin e Jugut armatimeve të reja dhe ekspertë ushtarakë. Tani ushtarë amerikanë kanë hyrë deri në zonat rurale për të komanduar trupat e Vietnamit jugor në veprim dhe marxivat bile marin pjesë në mizoritë kryesore kundër popullsisë. Përveç kësaj, si gjithnjë në zbatim të planit amerikan, autoritetet e Vietnamit jugor përpiqen të grumbullojnë një milion banorë në kampet e mëdha të përqëndrimit dhe kanë ndërmend krijimin e një zone të bardhë gjatë vijës së demarkacionit ushtarak provizore dhe kufijëve të Vietnamit jugor-Laos dhe Vietnamit jugor-Kambojë. Në lidhje me këtë, qeveria e Shteteve të Bashkuara vendosi t'i akordojë autoriteteve të Ngo Dinh Diemit një ndihmë suplementare, kasti i parë i së cilës kap shumë prej 400 milion dollarë. Përgatitjet për të futur

Viti:  
Dosja:

I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI  
Viti:  
Dosja: Fleta:

10

3.

forca t'armatosura amerikane si dhe plani i shtrirjes në shkallë të gjërë të ndërhyrjes së Shteteve të Bashkuara në Vietnamin e Jugut nuk janë vetëm një shkelje e thjeshtë e parimeve themelore të marrëveshjeve të Gjenevës, por një kërcënim direkt për paqën në Indokinë dhe në Jug-Lindjen e Azisë me tensionin shumë të lartë që ata shkaktojnë në Vietnamin e Jugut.

I dashur shoku Ministërë Marrëveshjet e Gjenevës u përgjigjen aspiratave të mbarë popullit vietnamit ashtu si dhe politikës paqësore që ka ndjekur dhe ndjek gjithmonë qeveria demokratike e Vietnamit. Prandaj përsa i përket asaj, ajo i është përmbajtur zbatimit rigoroz të klauzolave të marrëveshjeve dhe për më se një herë u ka propozuar autoriteteve të Jugut hapjen e një konference konsultative për diskutimin e reorganizimit të zgjedhjeve të lira në gjithë territorin e vendit, për ribashkimin e Vietnamit, ashtu si parashikohet në marrëveshjet. Të gjithë përpjekjet në sajë të drejtimit kanë shkuar kot, për arsye se autoritetet e Jugut i kanë hedhur poshtë kategorikisht këto propozime. Veprimet shumë të rrezikshme të Shteteve të Bashkuara dhe të autoriteteve të Vietnamit jugor që përmendëm shkaktojnë qetesimin më të madh në popullin e Vietnamit dhe në qeverinë demokratike të republikës demokratike të Vietnamit. Qeveria e Republikës demokratike të Vietnamit denoncon energjikisht përpara opinionit botëror manevrat e fundit dhe planet e Shteteve të Bashkuara për zgjerimin e agresionit në Vietnamin e Jugut, për futjen në këtë zonë të ushtrive të tyre. Përpara këtyre planeve dhe veprimeve të Shteteve të bashkuara që kërcenojnë jo vetëm paqën në Indokinë por edhe atë të të gjithë Azisë jug-lindore dhe të botës, shpresoj se qeveria e Republika Popullore e Shqipërisë, për hir të ruajtjes së paqes dhe forcimit të paqes botërore, do t'i kushtojë një kujdes të veçantë zhvillimit të rrezikshëm të situatës së tanishme në Vietnamin e Jugut për shkak të rrezikut të rëndësishëm të ndërhyrjes së Shteteve të Bashkuara, dhe do të përdorë të drejtat dhe influencën e saj për të dhënë kontributin e saj të çmuar në uljen e tensionit në këtë zonë. Ju lutem, shoku Ministër, pranoni sigurtimin e konsideratës sime më të lartë.

/.....